

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

UJESJELLES-KANALIZIME SH.A- SARANDE

Sarande, me 10.12.2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për : “MANE/S” Sh.p.k

NIPT J64103865K

Procedura e prokurimit : Kerkese per propozim

Numri i references se procedures : **REF-76892-10-28-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës : “Ndertim Pusi i Ri Nr.3/2020 ne Çuke-Ksamil dhe lidhja me tubacionin e transmetimit”

Fondi limit : **4,422,930 (katërmilion katerqind njezet e dymije e nenteqind e tridhjetë) leke pa TVSH**

Kriteret e për zgjedhjes së fituesit : çmimi më i ulët

Publikime të mëparshme : **Buletini i Njoftimeve Publike nr. 94, date 2 Nentor 2020**

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “COGREN” shpk NIPT **J74818825K** me oferte **3,999,999** (leke pa TVSH)
2. “ASI-2A CO” shpk NIPT **K53002402C** me oferte **4,229,387** (leke pa TVSH)
3. “MANE/S” shpk NIPT **J64103865K** me oferte **4,278,938** (leke pa TVSH)

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te 3 OE qe kane paraqitur ofert ekonomike, rezultoi 2 prej OE nuk i plotesonin kerkesat dhe kushtet e DST-se te hartuar nga AK, konkretisht

1. Operatori Ekonomik “COGREN” shpk

Kriteret e Vecanta te Kualifikimit

1. **Per Piken 2.3.3.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit per kete pike, rezulton se :

OE ka dorëzuar dokumentacionin si kontratat dhe diplomat për stafin inxhinierik në licence, por nga shqyrtimi i liste-pagesave të konfirmuara nga Drejtoria e Tatimeve Taksave, **Ing. Irakli Papadhima** nuk figuron në asnjë prej muajve të kërkuar në pikën 2.3.2 të DST-se të hartuar nga AK, në kundërshtim me përcaktimet e legjislacionit Shqiptar për Drejtuesat Teknik dhe Ligjin Nr.7703 dt 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

2. Për Pikën 2.3.4

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE për përmbushjen e kësaj pike, rezultojnë se:

- Në këtë pikë mundon një specialiste Hidraulik, pasi **z. Nestur Dhimojani** është pa kontratë me OE dhe figuron vetëm në liste-pagesën e Qershorit dhe në asnjë prej muajve të tjerë. Ndërsa spec.Hidarulik, Lorenc Kobuzi është me dokumentacion të rregullt sipas kërkesave të kësaj pike.
- Në këtë pikë, mundon një Specialiste elektrike, pasi znj.Lefteri Bodini nuk është e pajisur me Dëshmi të Kulifikimit për Sigurimin Teknik, pasi rezultojnë se kjo dëshmi të ketë mbaruar me **dt.12.10.2020**.

3. Për Pikën 2.3.6

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE për përmbushjen e kësaj pike, rezultojnë se:

- Për mjetin me targë SR3775B, OE ka dorëzuar vetëm kontratën e qirasë dhe certifikatën e pronësisë bashkëlidhur kontratës, dhe asnjë dokument tjetër të përcaktuar në kërkesat e kësaj pike.
- Për mjetin AA536GJ, OE ka dorëzuar si dokumentacion për këtë mjete, Leje Qarkullimi, SGS, Sigurim, Taksa dhe Kontrate qiraje, por rezultojnë që ky mjet është me kapacitet mbajtës mbi **1.5 t**, dhe si rezultat me dokumentacionin për këtë mjete duhet të dorëzohet dhe certifikata për transport malli nga ana e administratës së qeverisjes vendore, sipas përcaktimit ligjor.
- Për mjetin Sonde shpimi diametër 600mm, rezultojnë se OE nuk ka dorëzuar sigurim dhe taksat e këtij mjeti, si dhe bashkëlidhur kontratës të qirasë mundon prokurë e posaçme që pronari i mjetit z. Arveda Baholli, si pronar i mjetit, duhet të autorizonte nëpërmjet “Prokurës së Posaçme” të bijën dhe djalin për të lidhur këtë kontratë qiraje.

4. Për Pikën 2.3.7

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ky OE, rezultojnë se z.Aleko Lango është i pajisur me certifikatën e trajnimit si person (Përgjegjës për sigurim dhe mbrojtjes të shëndetit në punë), por OE nuk ka dorëzuar **kontratën e punës që ka me z.Aleko Lango**, sipas kërkesave të përcaktuara në këtë pikë.

Nga sa më sipër dhe në mbështetje të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 9643, datë 20.11.2006 të ndryshuar me Ligjin Nr. Ligjin Nr.103/2018, Neni.46 dhe Neni 55, KVO-ja konkludon se, oferta e OE “COGREN” shpk, nuk është e suksesshme, pasi nuk përmbushen të gjitha kriteret dhe kërkesat sipas DST-se të hartuar nga AK.

2. Operatori Ekonomik “ASI-2A CO” shpk

Kriteret e Vecanta te Kualifikimit

1. Per Piken 2.2.3

Per përmbushjen e kësaj pike OE nuk ka dorëzuar dokumentacionin “ Xhiron Vjetore” te leshuar nga Admistrata Rajonale e Tatim Taksave.

2. Per Piken 2.3.4

OE nuk ka dorezuar asnjë dokumentacion per te vërtetuar se ka te punësuar, dhe qe kane dëshmi te kualifikimit te sigurimit teknike, specialistet e kerkuar ne kete pike te DST-se.

3. Per Piken 2.3.5

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorëzuar per përmbushjen e kësaj pike rezulton se :

- Mjetet qe figurojnë ne regjistrat publike janë pa foto, per me teper mjeti me targa AA147RB rezulton te jete pa certifikat transporti mallrash, lëshuar nga administrata e qeverisjes vendore, si dhe per mjetin AA978AM kjo certifikat i ka mbaruar vlefshmëria me dt.27.06.2020.
- **Per mjetin Sonde shpimi d.600mm, OE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion per te vërtetuar se e ka me qera ose ne pronësi kete mjet.**

4. Per Piken 2.3.7

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorëzuar nga ky OE, rezulton se:

OE nuk ka dorëzuar asnjë domentacion per te vërtetuar se ka te punësuar, me kontrat dhe figuron ne listepagesat e shoqërisë, nje person te certifikuar per **(Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shëndetit ne pune).**

Nga sa me siper dhe ne mbeshteje te Ligjit te Prokurimit Publik Nr. 9643, datë 20.11.2006 te ndryshuar me Ligjin Nr. Ligjin Nr.103/2018, Neni.46 dhe Neni 55, KVO-ja konkludon se, oferta e OE “ASI-2A CO” shpk, nuk eshte e suksesshme, pasi nuk permbushen te gjitha kriteret dhe kërkesat sipas DST-se te hartuar nga AK.

Duke u nisur nga sa me siper renditja e operatoreve ekonomik eshte si me poshte:

- | | |
|--------------------------------------|---------------------|
| 1. “COGREN” shpk Nipt. J74818825K | Skualifikuar |
| 2. “ASI-2A CO” shpk Nipt. K53002402C | Skualifikuar |
| 3. “MANE/S” shpk Nipt. J64103865K | Kualifikuar |

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë : Shoqerine “MANE/S” Sh.p.k, NIPT J64103865K, me adresë : Sarande, Lagjia nr. 2, P. 46 , se oferta e paraqitur, me vlere 4,278,938(katermilion dyqind shtatedhjete e tetemije e nenteqind e tridhjete e tete) leke pa TVSH

është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Ujesjelles Kanalizime sh.a Sarande* kopjen e sigurimit të kontratës, si dhe te paraqiteni për nënshkrimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë më datë **02.12.2020**

Ankesa : Nuk ka patur